

Haxhiu: Pagat kalimtare me kosto 2 milionë euro të padrejta, por të ligjshme



Faqe 2

Supremja shfuqizon pjesë të rregullores së UP-së për avancimin e stafit akademik



Faqe 5

Tregtia, Irnai dhe Tajvani lartë në agjendën e takimit Trump - Xi



Faqe 6

Fitore dramatike e Trepçës në "Minatori"



Faqe 20

e enjte • 14 maj 2026

Numri 10362

KOHA DITORE

www.koha.net



NXIT REAGIME PUBLIKIMI I LISTAVE TË KANDIDATËVE PËR DEPUTETË

Pakënaqësi për listat

Reagime dhe pakënaqësi brenda disa subjekteve ka nxitur publikimi i listave të kandidatëve për deputetë. Disa prej emrave që kanë mbetur jashtë ose janë renditur më poshtë në listë kanë shprehur kritika ndaj përbërjes së saj. Reagimet më të mëdha janë bërë në LDK, ndërsa pakënaqësi janë shprehur edhe për PDK-në. E, LVV-ja është kritikuar edhe për përfshirje në listë të kandidatëve që kanë qenë të dënur

Ardit Kika

PRISHTINË, 13 MAJ – Publikimi i listave të kandidatëve për deputetë, është përcjellë të mërkurën edhe me pakënaqësi brenda subjekteve politike e edhe me reagime jashtë tyre.

Më të mëdhatë kanë qenë në Lidhjen Demokratike (LDK). Në listën e këtij subjekti politik sipër u ranguan shumë eksponentë të propozuar nga Vjosa Osmani, e cila është rikthyer në këtë parti pas më shumë se pesë vjetësh, kur e kishte braktisur për t'iu bashkuar Vetëvendosjes, me nismën e saj "Guxo".

Emra që dikur përfaqësonin një pjesë të rëndësishme të strukturës së saj, por që tash janë zhvendosur nga top 10-shja e disa kanë mbetur jashtë garës, kanë shprehur pakënaqësi ndaj përbërjes së listës që udhëhiqet nga Osmani.

Mes reagimeve më të zëshme ishte ai i ish-deputetes më të votuar të LDK-së në zgjedhjet e kaluara, Hykmete Bajrami, e cila kritikoi përfshirjen e personave që, sipas saj, dikur ishin kundër LDK-së.

"Nga zyra e LDK-së më është kumtuar se në listë unë jam me numër 12, pas njerëzve që deri dje e kanë luftuar LDK-në, por kjo për mua personalisht s'paraqet asnjë problem, sepse beteja ime nuk është për renditje as për fitore personale", ka thënë ajo. "Beteja ime është për një Kosovë që nuk i nënshtrohet arrogancës së pushtetit; për politikën që i shërben qytetarit e

jo interesave personale; për demokracinë që nuk tkurret; për qytetarin që kërkon llogari nga qeveria; për biznesin që nuk pengohet nga politika dhe për institucione që nuk kapen nga partitë".

E ish-kryeministri Avdullah Hoti, që është renditur po ashtu në dhjetëshen e dytë, ka shkruar në Facebook se "numri i vetëm që ka rëndësi është numri i Lidhjes Demokratike të Kosovës", duke shtuar se numrat e tjerë i përcaktojnë qytetarët.

Ka reaguar edhe ish-deputeti i kësaj partie, Arben Gashi, i cili ka qenë edhe kryetar i grupit parlamentar të kësaj partie. Ai ka shkruar se "ndonëse renditja ka peshë megjithatë më e rëndësishme është lidhja që krijohet me qytetarin, besimi që ndërtohet dhe puna që bëhet me përkushtim".

Jashtë listës ka mbetur ish-deputeti nga Prizreni, Xhavit Ukaj, por ka thënë se do të angazhohet për ta ndihmuar partinë.

Në dhjetëshen e parë të LDK-së pos Osmanit janë edhe dy kandidatë që ajo i ka prezantuar si prurje të reja - Alben Reshitajn e Jeta Stavocin, të cilat në legjislaturën e kaluar ishin deputetë të koalicionit qeveritar.

Në listën e LDK-së, në dhjetëshen e dytë si prurje nga ish-presidentja Osmani janë futur edhe Fahrrije Hoti e Burim Meta.

vijon në faqen e dytë



Prishtinë, 13 maj – Ministria e Punëve të Jashtme ka njoftuar se kryenegociatori i Kosovës në dialogun teknik për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë, Agron Bajrami, të mërkurën gjatë takimit me të dërguarin e posaçëm të Bashkimit Evropian për këtë proces, Peter Sorensen, ka shprehur qëndrimin se progresi në dialog varet nga llogaridhënia e Serbisë për sulmin terrorist në Banjaskë. Gjatë ditës, Sorensen ka njoftuar se ka zhvilluar takime të ndara në Bruksel, në nivel kryenegociatorësh

REZULTON E JASHTËLIGJSHME DISPOZITA QË PARASHIHTE DETYRIME TË REJA FINANCIARE GJATË QËNDRIMIT NË KLINIKA

Supremja shfuqizon tarifën prej 3 eurosh për shoqëruesit e pacientëve në QKUK

Vlerë Mehmeti

PRISHTINË, 13 MAJ – Gjykata Supreme e ka shpallur të paligjshme tarifën prej 3 eurosh për personat shoqërues mbi 15 vjeç të pacientëve gjatë qëndrimit në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK), duke shfuqizuar pjesërisht Udhëzimin Administrativ nr. 03/2024 për bashkëpagesat në shërbimet shëndetësore.

Vendimi u mor pas padisë së paraqitur nga Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) kundër Ministrisë së Shëndetësisë (MSH), me të cilën është kontestuar ligjshmëria e dis-

pozitive që parashihnin pagesë prej 3 eurosh për çdo ditë qëndrimi në spital për shoqëruesit e pacientëve mbi moshën 15-vjeçare.

Sipas IKD-së, Ligji për Shëndetësi e definon bashkëpagesën si pagesë për shërbime të kujdesit shëndetësor nga personat që i shfrytëzojnë ato, ndërsa personat shoqërues nuk mund të konsiderohen përfitues të shërbimeve shëndetësore, pasi nuk marrin trajtim mjekësor apo shërbime diagnostike e rehabilituese.

Supremja ka vlerësuar se dispozitat e kontestuara nuk kishin bazë të mjaftueshme ligjore dhe zgjerimin

në mënyrë të palejuar nocionin e "bashkëpagesës".

"Gjykata Supreme, pas administrimit të provave dhe shqyrtimit të dispozitave kushtetuese dhe ligjore, ka vlerësuar se dispozitat e kontestuara nuk kanë bazë të mjaftueshme ligjore dhe se përmes tyre është zgjeruar në mënyrë të palejuar nocioni i 'bashkëpagesës'. Në aktgjykim, Gjykata Supreme thekson se bashkëpagesa mund të vendoset vetëm ndaj personave që janë përfitues të drejtpërdrejtë të një shërbimi shëndetësor. Sipas vlerësimit të Gjykatës, personi shoqërues nuk e plotëson këtë

kriter, pasi prania e tij në institucionin shëndetësor lidhet me mbështetjen e pacientit dhe jo me marrjen e shërbimeve shëndetësore", thuhet në vendim.

Në aktgjykimin e Supremes thuhet se bashkëpagesa mund të vendoset vetëm ndaj personave që janë përfitues të drejtpërdrejtë të një shërbimi shëndetësor, kriter të cilin personat shoqërues nuk e plotësojnë. Gjykata gjithashtu ka konstatuar se Ministria e Shëndetësisë ka tejkalluar autorizimet ligjore përmes këtij udhëzimi administrativ.

vijon në faqen e pestë

"Dua" që kthen kohën, godet në Cannes, e pret rrugëtim i gjatë



Është një realitet të cilin e ka përjetuar thuajse secili adoleshent që fati e ka përplasur me vitet '90 në Kosovë. S'ka qenë i lirë të dalë në një "pub" apo disko për të testuar veten në vallëzim apo për t'u njohur me dikë. E kur ka dalë, është përballur me ndjekjet e policisë serbe, gjoja për prishje të rendit publik. Por telashi i pushtetit...

Faqe 14